

NJOFTIM PER PROKURIM SHERBIMI

Specialist komunikimi për projektin NO-BLE Ideas

1. Referenca

SEE/D/0335/1.1/X

2. Procedura

Me tender, pagesa me bazë mujore

3. Programi

Programi i Bashkëpunimit Transkombëtar të Evropës Juglindore (SEE)

4. Financimi

Marrëveshja e financimit: faza e integruar IPA(faza e 2-të për vitet 2010-2013) nën programin SEE

5. Autoriteti Kontraktues

- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
-

SPECIFIKIMET E KONTRATES

6. Natyra e kontratës

Pagesa me bazë mujore. Eksperti mund të rimbursohet për shpenzimet e udhëtimit.

7. Përshkrimi i kontratës

Objekti i kësaj Kontrate është koordinimi i Zyrës Lokale të projektit “YOUNG INNOVATORS NETWORK FOR SUSTAINABLE IDEAS IN THE AGRO-FOOD SECTOR” që menaxhohet nga Drejtorja e Integritit dhe Menaxhimit të Fondeve IPA në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

8. Numri dhe titujt e lote-ve

S'ka

9. Buxheti maksimal

4200.00 EURO

KUSHTET E PJESEMARRJES

10. Ligjshmëria

Pjesëmarrja është e hapur për të gjithë personat juridikë në Vendet Anëtare të Bashkimit Evropian ose në shtete ose territore të rajoneve që mbulohen dhe/ose janë të autorizuarë nga instrumenta specifike të aplikueshëm për programet nga të cilat financohet kontrata. (shih gjithashtu pikën 23 më poshtë). Pjesëmarrja është gjithashtu e hapur për organizata ndërkombëtare. Pjesëmarrja e personave fizikë duhet të bëhet në bazë të instrumentave specifike të aplikueshëm për programin nga do të financohet kontrata.

11. Numri i ofertave/aplikimeve

Jo më shumë se një ofertë/aplikim mund të dorëzohet nga një person juridik apo fizik në çfarëdo lloj forme pjesëmarrje (si një entitet individual juridik ose si një drejtues apo anëtar i një konsorciumi që paraqet një ofertë). Në rast se një person fizik apo juridik paraqet më shumë se një ofertë, të gjitha ofertat e personit do të përjashtohen.

12. Bazë për përjashtim

Si pjesë e tenderit, aplikuesit duhet të dorëzojnë një deklaratë të firmosur të përfshirë në formularin e tenderit, me qëllim të konfirmimit se ata nuk janë në asnjë nga situatat e përjashtimit që listohen në Seksionin 2.3.3 të Udhëzuesit Praktik për procedurat e kontraktimit për veprimet/aktivitetet e jashtme të BE.

13. Nën-kontraktimi

Nën-kontraktimi nuk lejohet.

AFATAT KOHORE TE MUNDSHME

14. Data e mundshme e fillimit të kontratës

1 Shkurt 2014

15. Periudha e zbatimit të detyrave

Periudha e zbatimit të kontratës individuale për Koordinator të Zyrës Lokale duhet të jetë 8 muaj, duke filluar nga 1 Shkurt – 30 Shtator 2014.

KRITERET E PERZGJEDHJES DHE PERCAKTIMIT TE FITUESIT

16. Kriteret e përzgjedhjes

Kriteret e mëposhtme të përzgjedhjes do të aplikohen për aplikantët/tenderuesit. Në rastin e aplikimeve/ofertave të dorëzuara nga një konsorcium, këto kritere përzgjedhje do të aplikohen ndaj konsorciumin si një të tërë:

- 1) **Aftësia profesionale e aplikuesit**
 - Diplome universitare

- Të kenë njohuri shumë të mira në anglishten e folur dhe të shkruar, dhe të zotërojë gjuhën shqipe;

2) Kapacitetet teknike të aplikuesit

- Të kenë aftësi në komunikim,
- Të kenë njohuri kompjuterike: MS Office, Power Point, Outlook;web
- Njohje mbi projektet me financim të huaj, kryesisht të BE;

17. Kriteret e përcaktimit të fituesit

Kandidatët më të mirë do të listohen sipas një Filtri Vlerësues.

TENDERIMI

18. Afati përfundimtar për marrjen e ofertave/aplikimeve

28 Janar 2014, ora 16:00.

19. Si do të dorëzohen aplikimet

Aplikimet duhet të dorëzohen tek Autoriteti Kontraktual, duke përdorur mjetet e specifikuar në thirrjen për shprehje interesi të publikuar në website www.bujqesia.gov.al

Aplikimet e dorëzuara me ndonjë mjet tjetër nuk do të merren në konsideratë.

20. Ndryshimi ose tërheqja e aplikueseve

Aplikuesit mund të ndryshojnë ose të tërheqin aplikimet e tyre me një njoftim me shkrim përpara afatit përfundimtar të dorëzimit të aplikimeve. Asnjë aplikim nuk mund të ndryshohet pas afatit përfundimtar.

21. Gjuha e komunikimit

Të gjitha komunikimet e shkruara për këtë procedurë tenderi dhe kontrata duhet të jenë në Shqip dhe Anglisht.

22. Baza ligjore

Rregullorja e Këshillit (EC) No. 1085/2006 e datës 17 Korrik 2006 duke krijuar një instrument të Asistencës të Parazgjerimit (IPA) - OJ L 210 në 31 Korrik 2006.

24. Informacion shtesë si ora e hapjes të Autoritetit Kontraktues.

S'ka